

MIRATOHET: PËR K.K.T.K.M SEKRETARI

Joli MITROJORGJI

**RESTAURIMI KISHËS SË “PROFETIT ILIA”, NË
LEKËL – TEPELENË, PAS DËMTIMEVE TË
SHKAKTUARANGA ZJARRI I DATËS 12.08.2025.**

RELACION TEKNIK

Pergjegjes Sektori:

Ark. Ronela Çuku

Punuan:

Ark. Elina Manushi

Ark. Andoniu Deli

Ark. Vilma Hashorva


Ing. Vasil Polo

Përmbajtja:

1. *Vendndodhja*
2. *Veshtrim historiko-arkitektonik*
3. *Gjendja ekzistuese*
4. *Qëllimi i projektit*

1. Vendndodhja

Lekli është një fshat malor rreth 800 m. mbi nivelin e detit, 12 km. larg Tepelenes ose 6 km nga Uji i Ftohtë, gjatë rruges automobilistike që e lidh me qytetin e Permetit. Kisha ngrihet në një pozite zotuese, prej nga hapet një pamje e gjere mbi peisazhin rrethues. Fshati Lekël ndodhet në Njësinë Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë, në qarkun e Gjirokastrës. Ai shtrihet në krahun lindor të rrugës nacionale Tepelenë–Gjirokastrë, rreth 14 km larg qytetit të Tepelenës. Lekli është një fshat kodrinor-malor, i vendosur në shpatet e malit Trebeshinë, me një peizazh të thyer e panoramë të gjerë mbi luginën e Vjosës. Zona është e pasur me trashëgimi historike e kulturore, përfshirë kishat, banesat tradicionale dhe toponime të lashta. Pozicioni i fshatit, në një zonë me vlera natyrore e kulturore, e bën atë një nga vendbanimet karakteristike të krahinës së Labërisë



Figurë 1. Vendndodhja e kishes në lidhje me fshatin




Figurë 2. Vendndodhja e kishes

2. Veshtrim historiko-arkitektonik

Kisha ngrihet në një pozicion të lartë dhe të dukshëm, nga ku ofrohet një pamje panoramike mbi peizazhin përreth. Ajo gëzon statusin Monument Kulture i Kategorisë së Dytë. Për ndërtimin e Kishës ruhet ende një gojëdhënë që e lidh atë me emrin e Ali Pashë Tepelenës. Duke shkuar për në Janinë, Pashai i jep urdhër një ushtari besnik të tij nga Lekli, Thanas Vajes, që të ndërtohej një xhami mbi shkëmbin më të ekspozuar të fshatit. Në kundërshtim me urdhrin e Pashait, ushtari çon fjalë në fshat që në atë vend të ndërtohej një kishë. Në kthim, Pashai, i habitur, pyet ushtarin pse nuk ishte zbatuar urdhëri i tij, dhe ushtari i përgjigjet se e ndërtoi këtë kishë për kauret (të krishterët), sepse kishin kohë që e kishin kërkuar. Në atë kohë, fshati kishte rreth 600 familje të krishtera. Kisha është e tipit bazilikal trenefëshe. Dy radhët e kollonave prej guri, që ndajnë nefet, lidhen ndërmjet tyre dhe me muret perimetrale me harqe, duke krijuar një numër të madh

berthamash të mbuluara me kalota sferike, ndërsa berthamat e ambientit të altarit janë të mbuluara me qemere cilindrike. Ambienti i altarit përmban tre apsida të nxjerra jashtë. Naosi nuk përmban piktura murale, ndërsa të gjitha pajisjet e saj të brendshme janë zhdukur. Në anën perëndimore, naosi lidhet me narteksin, i cili ka shërbyer edhe si dhomë pagëzimi. Në qoshen jugperëndimore të narteksit ngrihet kulla e këmbanares. Sipas gjurmëve, në anën veriore duhet të ketë qenë zhvilluar hajati. Muratura dhe sistemi i mbulesës janë ndërtuar me gurë jo të rregullt, të lidhur me llaç gëlqereje. Trajtimi i jashtëm është shumë i thjeshtë, ku mbizotëron masa e muraturës së gurit dhe mungesa e elementeve dekorative. Të vetmet elemente ku tenton të thyhet kjo thjeshtësi janë apsidat në pamjen lindore, të cilat janë trajtuar me një varg harkdash të verbëta. Çatia e gjerë dyujëshe, e prera në anën lindore, është e mbuluar me tufa tjegulle. Gjatë periudhës së diktaturës komuniste, kisha ishte transformuar krejtësisht. Naosi ishte kthyer në vatër kulture, narteksti në furrë buke, ndërsa në anën veriore ishte ndërtuar një shtesë që shërbente si ambulancë e fshatit. Përveç kësaj, braktisja e ndërtesës për një kohë të gjatë kishte krijuar probleme serioze për qëndrueshmërinë statike të saj. Vereheshin dekompozime të llaçit lidhës, dëmtime të çatisë së kishës, dalja jashtë funksionit e tirantave të harqeve, çarje në muraturë dhe në sistemin e mbulesës së kurbëzuar të interierit, si dhe dobësime të seksionit mbajtës të kollonave, sidomos në kapitelet e tyre ose në kontaktet me thembrat e harqeve. Kisha e Leklit, e ndërtuar rreth viteve 1750–1780 dhe e mbetur si një nga monumentet më të veçanta të këtij fshati, në vitet '90 iu nënshtrua një procesi të plotë restaurimi, me synimin për të siguruar qëndrueshmërinë e saj dhe për të rikthyer tiparet arkitektonike e funksionale. Punimet përfshinë pastrimin e ndërtesës, heqjen e suvave, çatisë dhe shtesave të mëvonshme, si dhe qepjen e çarjeve me shufra hekuri. U krye fugatimi i muraturës, përforcimi i kollonave dhe harkëve, vendosja e tirantave të rinj metalikë, rindërtimi i çatisë dhe rikrijimi i hajatit verior mbi gjurmët ekzistuese. Brendësia u përmirësua me suvaje të reja, shtrimin e dyshemesë me pllaka guri, si dhe hapjen e hapësirave të mbyllura më vonë, duke u pajisur me dyer e dritare sipas skemës origjinale. Po ashtu, u krye sistemimi i territorit përreth dhe u instaluan linjat elektrike të brendshme e të jashtme. Me këto ndërhyrje, Kisha e Leklit rifitoi vlerat e saj si një dëshmi e gjallë e arkitekturës së kultit dhe e pranisë së krishterimit në këtë krahinë. Megjithatë, për kompletimin e saj të plotë, mbetet ende e nevojshme pajisja me elementët e brendshëm liturgjikë, si ikonostasi, ikonat, froni peshkopal dhe prosqinitaret.



Figurë 3. Pamje te kishes



Figurë 4. Pamje te kishes



Figurë 5. Pamje te kishes



Figurë 6. Pamje te kishes

3. Gjendja ekzistuese

Më datë 12 gusht 2025, çatia e Kishës së Profetit Ilia në fshatin Lekël, Monument Kulture i Kategorisë II, u shkrumbua totalisht nga një zjarr i papritur. Flakët shkatërruan mbulesën e çatisë dhe elementët mbajtës të saj, duke e lënë ndërtesën të ekspozuar ndaj faktorëve atmosferikë dhe rrezikut të përparimit të dëmtimeve strukturore. Fatmirësisht, zjarri nuk depërtoi brenda objektit, duke ruajtur muraturën, naosin, narteksin dhe pjesët e tjera të brendshme, megjithëse dëmtimi i çatisë e bën ndërtesën të pambrojtur ndaj shiut dhe kushteve të tjera të motit, duke rrezikuar integritetin e saj të përgjithshëm. Ky incident tregon qartë rrezikun serioz që përbëjnë flakët për monumentet e trashëgimisë kulturore dhe nevojën për ndërhyrje të menjëhershme.



Figurë 7. Pamje te kishes gjendje ekzistuese



Figurë 8. Pamje te kishes gjendje ekzistuese



Figurë 9. Pamje te kishes gjendje ekzistuese



Figurë 10. Pamje te kishes gjendje ekzistuese

4. Qëllimi i projektit

Projekti ka për qëllim kryesor restaurimin dhe konsolidimin e çatisë, e cila përveç funksionit strukturor, siguron mbrojtjen e brendshme të Kishës nga shirat dhe lagështia. Ai synon rikthimin e qëndrueshmërisë së ndërtimit, ruajtjen e tipologjisë dhe karakteristikave arkitekturore origjinale, si dhe mbrojtjen e monumentit nga dëmtime të mëtejshme. Projekti ka gjithashtu qëllimin e rikthimit të funksionit dhe vlerave historike, kulturore dhe estetike të ndërtesës.

5. Ndërhyrjet e propozuara

- Shkulje rrenjeve bimeve të vogla pranë strukturave;
- Transport materiale me kafshë, deri në 1km;
- Pastrim i suvatimit dhe mbushjeve me llac në muret e objektit nga jashtë (heqje e suvatimit në kupola, në çati)
- Çmontim mur guri me pastrim (çmontim i gureve të dëmtuar në kupola, pas identifikimit dhe heqjes së suvatimit);
- Pastrim i suvatimit dhe mbushjeve me llac në muret e objektit nga jashtë (heqje e suvatimit në kupola, në çati) ;
- Pastrim i murit në krye, nën çati;
- Restaurim mur guri llaç gëlqere 1:3 (Restaurim i gureve në kupola);
- Shtrese llaci horasan mbi kupola;
- Konsolidim i kreut të murit me 2cm llaç gëlqere 1:3
- Restaurim i kornizës me pllaka guri si origjinali, (2 rradhe të drejta + një rresht i dhembësuar) dhe nënshtresa e saj;
- Çmontim dritare;
- F.V dritare druri kasë bëj me teke xham;
- F.V dritare druri cilesi e I-re;
- Prishje e suvatimit të degraduar në mur guri;
- Suva brenda mur guri ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25
- Riparim, suvatimi dhe retukim i pjeseve të dëmtuara të suvase me llac gëlqere, në interiorin e kishës;
- Sherbetisje e bojatisje me gëlqere;
- Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim);
- Pastrim i fasadës nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqësore me ujë me pompe me presion (idropulitrice);
- Restaurim shkalle guri në anën jugore;
- Rindërtim i çatisë, sipas skemës ekzistuese të çatisë së djegur;
- Ndërtim tavani prej druri;
- Furnizim vendosje fikse zjarri;

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25						
PROJEKT RESTAURIMI, ÇATIA E “KISHËS SË PROFET ILIAS” LEKËL-TEPELENË																						Tiranë, 2025								
FASADA LINDORE PATOLOGJI + NDERHYRJE																														
																						SHËNDIME Më datë 12 gusht 2025, çatia e Kishës së Profet Ilia në Lekëll-Tepelenë është shprehur në gjendje të këqijë dhe ka nevojë për restaurim të menjhërtë. Çatia është e rëndësishme për mbrojtjen e strukturës së kishës dhe për ruajtjen e vlerave historike. Restaurimi duhet të kryhet me materiale origjinale dhe me teknika tradicionale.								
FASADA VERIORE PATOLOGJI + NDERHYRJE																						MIRATOHET për K.K.T.K.M. Sekretari JOLI MITROJORGJI								
																						OBJEKT PROJEKT RESTAURIMI, ÇATIA E “KISHËS SË PROFET ILIAS” LEKËL-TEPELENË								
PROJEKT ZBATIMI <table border="1"> <tr> <td>DESIGNIMI</td> <td>ORIENTIMI</td> <td>ORIENTIMI</td> </tr> <tr> <td>PATOLOGJI + NDERHYRJE</td> <td>ORIENTIMI</td> <td>ORIENTIMI</td> </tr> </table>																						DESIGNIMI	ORIENTIMI	ORIENTIMI	PATOLOGJI + NDERHYRJE	ORIENTIMI	ORIENTIMI	PERGJEGJES SEKTORI Ark. Rona Cini PROJEKTOI Ark. Elza Mamed Ark. Andon Doli Ark. Vilma Hoxha Ing. Vasil Pali Data: Tetor, 2025 SH. 101		
DESIGNIMI	ORIENTIMI	ORIENTIMI																												
PATOLOGJI + NDERHYRJE	ORIENTIMI	ORIENTIMI																												
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25						



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)